Kur t'i shohësh ata që ndjekin ajetet jo krejtësisht të qarta, këta janë ata të cilët Allahu i ka përmendur. Andaj, ruajuni prej tyre!

Aishja (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon: "I Dërguari i Allahut e lexoi këtë ajet: “Është Ai që të ka shpallur ty (Muhamed) Librin, disa ajete të të cilit janë të qarta e me kuptim të drejtpërdrejtë. Ato janë themelet e Librit, kurse disa (ajete) të tjera janë jo krejtësisht të qarta (me kuptime alegorike). Ata, zemrat e të cilëve priren nga e pavërteta, ndjekin ajetet më pak të qarta, duke kërkuar të krijojnë pështjellim dhe duke kërkuar t'i komentojnë sipas dëshirës së vet. Por, kuptimin e tyre të vërtetë e di vetëm Allahu. Ndërkaq, ata që janë thelluar në dijeni, thonë: "Ne i besojmë (Kuranit). Të gjitha këto (ajete të qarta e alegorike) janë nga Zoti ynë! Këtë e kuptojnë vetëm mendarët.” (Al Imran, 7) - dhe tha: “Kur t'i shohësh ata që ndjekin ajetet jo krejtësisht të qarta, këta janë ata të cilët Allahu i ka përmendur. Andaj, ruajuni prej tyre!”

[Sahih] [Muttefek alejhi]

Profeti ﷺ e lexoi këtë ajet: “Është Ai që të ka shpallur ty (Muhamed) Librin, disa ajete të të cilit janë të qarta e me kuptim të drejtpërdrejtë. Ato janë themelet e Librit. Kurse disa (ajete) të tjera janë jo krejtësisht të qarta (me kuptime alegorike). Ata, zemrat e të cilëve priren nga e pavërteta, ndjekin ajetet më pak të qarta, duke kërkuar të krijojnë pështjellim dhe duke kërkuar t'i komentojnë sipas dëshirës së vet. Por, kuptimin e tyre të vërtetë e di vetëm Allahu. Ndërsa ata që janë thelluar në dijeni, thonë: "Ne i besojmë (Kuranit). Të gjitha këto (ajete të qarta e alegorike) janë nga Zoti ynë! Këtë e kuptojnë vetëm mendarët.” (Al Imran, 7) Në këtë ajet, Allahu i Lartësuar tregoi se Ai është që ia zbriti Profetit të Tij Kuranin, i cili përfshin ajete me kuptim të qartë, vendimet e të cilit janë të ditura e nuk ka pështjellime, e të cilat janë themelet e Librit dhe referenca e tij, respektivisht janë referencë kur ka mospajtime. Ka edhe ajete të tjera që bartin më shumë se një kuptim, kuptimi i të cilave disa njerëzve u përzihet, ose mendojnë se ka kontradiktë midis tyre dhe ajeteve të tjera. Më pas Allahu e sqaroi se si duhet të sillen njerëzit me këto ajete; kështu që ata, zemrat e të cilëve priren nga e pavërteta, i braktisin ajetet e qarta e me kuptim të drejtpërdrejtë, e i marrin ajetet jo krejtësisht të qarta, e që bartin disa kuptime, duke synuar me këtë të ngjallin dyshime dhe t'i devijojnë njerëzit, si dhe synojnë t'i interpretojnë sipas asaj që pajtohet me dëshirat e tyre, ndërsa ata që janë të palëkundur në dituri, e dinë se këto janë ajete jo krejtësisht të qarta, kështu që i kthejnë tek ajetet e qarta e me kuptim të drejtpërdrejtë; u besojnë dhe besojnë se janë prej Allahut të Lartësuar, e nuk mund të pështjellohen ose të kenë kontradiktë mes vete, por vetëm ata me mendje të shëndoshë mund të marrin mësim. Pastaj Profeti ﷺ i tha nënës së besimtarëve, Aishes (Allahu qoftë i kënaqur me të!), se, kur t'i

shohësh ata që ndjekin ajetet jo krejtësisht të qarta, këta janë ata të cilët Allahu i ka përmendur në fjalën e Tij: "Ata, zemrat e të cilëve priren nga e pavërteta", andaj ruajuni prej tyre e mos i dëgjoni!

https://sunnah.global/hadeeth/sq/show/65062